



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202100990/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2021

**Lënda:** Rekomandim për inspektimin e kryer në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë në Komisaratin e Policisë Sarandë.

**Drejtuar:** Drejtues i Parë Gentian BERBERI  
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë

VLORE

Z. Klodjan KONDI  
Shef i Komisarimit të Policisë Sarandë

SARANDË

**Për dijëni:** Drejtues Madhor Gledis NANO  
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë të Shtetit

TIRANË

*Të nderuar zotërinj,*

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr. 81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në ambientet e privimit të lirisë të personit në Komisaratin e Policisë Sarandë.

Inspektimi u krye në datën 01.07.2021, sipas Planit të Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Ermonela Xhafa, Komisionere e MKPT-së, znj. Gloria Çarkaxhiu, z. Besnik Deda dhe z. Hazbi Selita me detyrë Nd/komisioner pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, procedurën standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, procedurën standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, si

dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimit të mëparshëm.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, si më poshtë vijon:

### **Shënime të përgjithshme**

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas që iu është privuar liria, grupi i punës u takua me Shefin e Komisarariatit të Policisë Sarandë z. Syrja Bello dhe shefin e rendit z. Adhurim Dulaj, të cilët u vunë në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim, Shefi i Komisarariatit raportoi për grupin e inspektimit, mbi masat e marra për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Institucioni i Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, në lidhje me masat e marra për përmirësimin e kushteve në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në procedurat standarde dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim.

Grupi punës inspektoi ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë, u njoh me regjistrat dhe dokumentacionin ku pasqyrohen të dhënat dhe veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar, si dhe vizitoi zyrat e punës të punonjësve të policisë të këtij komisaritati.

Një vëmendje e veçantë iu kushtua zbatimit të masave të protokollit shëndetësor për parandalimin e COVID-19 në mjediset e komisarariatit. U evidentua se, punonjësit e policisë ishin të pajisur me maska mbrojtëse dhe ruanin distancën fizike me njëri-tjetrin. Në vende të aksesueshme (korridore) ishin vendosur dezinfektant për pastrimin e duarve. Gjithashtu, dezinfektantë për pastrimin e duarve ishin vendosur edhe në korridorin ku ndodhej ambienti i shoqërimit, si dhe në zyrat e punës të punonjësve të policisë. Maskat mbrojtëse dhe dezinfektantët ishin siguruar nga vetë institucioni.

Nga informacioni i drejtuesve të komisarariatit, si dhe nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit të vitit të kaluar, rezultoi se:

- **Nuk ishte realizuar** rekomandimi, për marrjen e masave të menjëhershme për mbylljen dhomave ekzistuese të sigurisë në Komisariatin e Policisë Sarandë, pasi ato nuk plotësojnë asnjë nga kriteret e parashikuara në procedurat standarde të më sipër cituara.
- **Nuk ishte realizuar** rekomandimi, për marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin e ambienteve të reja të sigurisë sipas procedurave standarde: “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1102, datë 07.11. 2017 në Komisarariatet e Policisë Sarandë dhe Vlorë, të cilat të jenë të pajisura me sistemin e kamerave.
- **Nuk ishte realizuar** rekomandimi, për marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin në Komisarariatet e Policisë Sarandë të ambienteve të shoqërimit sipas kriterëve të parashikuara në procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit

në polici”, miratuar me Urdhrin nr.938, datë 24.07.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orëditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur, të pajisur me sistemin e kamerave.

- **Nuk ishte realizuar** rekomandimi, për marrjen e masave të nevojshme për krijimin dhomës (zyrës) më vete në ambientin e sigurisë, për marrjen në pyetje të personave të ndaluar/arrestuar, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera.
- **Nuk ishte realizuar** rekomandimi, për marrjen e masave të nevojshme për krijimin të dhomës (zyrës) në ambientin e shoqërimit, për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera.
- **Nuk ishte realizuar** rekomandimi, për marrjen e masave të nevojshme me qëllim plotësimin me saktësi dhe përgjegjësi të “Regjistrave të evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” nga punonjësit e policisë në Komisaritet e Policisë Sarandë.
- **Nuk ishte realizuar** rekomandimi, për marrjen e masave për vendosjen e materialeve promovuese (postera) për njohjen e personave të shoqëruar dhe personave të arrestuar/ të ndaluar në Komisaritetin e Policisë me të drejtat e tyre në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj.

Grupi i inspektimit, pasi mori informacionin e nevojshëm lidhur me qëllimin e vizitës inspektuese, vijoi takimin me punonjësin e informacionit dhe përgjegjësin e dhomave të sigurisë në Komisaritetin e Policisë Sarandë, inspektoi kushtet e mjedisit të shoqërimit dhe të sigurisë, vizitoi zyrat e punës të punonjësve të policisë të cilët kryenin veprime procedurale hetimore me personat e shoqëruar, si dhe u njoh e administroi dokumentacionin ku ishin evidentuar të dhënat dhe veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar, gjatë kohës së qëndrimit në mjediset e këtij komisariteti.

Theksojmë se, drejtuesit dhe punonjësit e policisë të Komisaritetit të Policisë Sarandë me të cilët kontaktoi grupi i inspektimit, u treguan bashkëpunues gjatë komunikimit, si dhe inspektimit që u zhvillua në ambientet e këtij institucioni.

Në përfundim të inspektimit, pavarësisht disa masave që ishin marrë për respektimin e të drejtave ligjore të personave të shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar, në Komisaritetin e Policisë Sarandë vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika si më poshtë:

### **Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre**

Ambienti i shoqërimit në Komisaritetin e Policisë Sarandë, nuk ishte i ndërtuar sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, ku parashikohet se dhomat e shoqërimit duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të

bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit.<sup>1</sup>

Grupi inspektimit konstaton se ishte vetëm 1 (një) ambient shoqërimi, në formën dhomë-paradhomë. Ky ambient shërbente sipas nevojave, për shoqërimin e personave të rritur dhe femrave. Ndriçimi natyral dhe ajrimi në paradhomë ishte i mjaftueshëm, ndërsa në dhomë ndriçimi dhe ajrimi bëhej indirekt nga paradhoma dhe ishte i pamjaftueshëm. Gjithashtu, dhoma dhe paradhoma kishin ndriçim artificial nga rrjeti elektrik. Ato ishin të lyera dhe të pastra. Në fundin e dhomës ndodhej një tualet për plotësimin e nevojave të personave të shoqëruar.

Korridorin e këtij ambienti **nuk** ishte i monitoruar me sistemin e kamerave. Në korridor dhe brenda në dhomat e shoqërimit ishin të vendosura postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në gjuhën shqipe. Ndërsa për shtetasit e huaj, karta e të drejtave ishte përkthyer në disa nga gjuhët e huaja kryesore.

Pavarësisht rekomandimeve të mëparshme të Avokatit të Popullit, në Komisaratin e Policisë Sarandë ngelet si problematikë, mungesa e dhomave të shoqërimit më vete për femra dhe të miturit dhe e sistemit të monitorimit me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe ambientit të shoqërimit.

Nga inspektimi u evidentua se, **nuk** kishte dhomë më vete për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar dhe intervistimi i tyre kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë. Ndërsa, për intervistimin/marrjen në pyetje të të miturve që shoqëroheshin në mjediset e komisarimit, ishte krijuar “Njësia për intervistimin e të miturve”, projekt i mbështetur nga UNICEF dhe Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, në kuadër të programit “Transformimi i përgjigjes kombëtare ndaj trafikimit të qenieve njerëzore në dhe nga Shqipëria 2019 – 2021”.

Nga verifikimi i dokumentacionit, u konstatua se, në këtë komisarimit zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit të çështjes përkatëse. Ky dokument plotësohet në dy kopje, një kopje e të cilit mbahej nga punonjësi i policisë në zyrën e informacionit.

Nga verifikimi i disa praktikave të njëpasnjëshme, u evidentuan se, në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë të Komisarimit, një kopje e procesverbalit pasi firmosej, i jepej edhe personit të shoqëruar.

Nga inspektimi i ambienteve në mjedisin e shoqërimit, nuk u gjetën sende apo mjete të tilla që mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve të personave apo për kundërveprim ndaj punonjësve të policisë.

---

<sup>1</sup> *Kreu VI, pika 3 e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.*

Në kohën e inspektimit, kishte një person të shoqëruar në dhomat e shoqërimit të këtij komisariati. Ndërsa për periudhën Janar - Korrik 2021 në regjistër ishin evidentuar të dhënat për 319 persona të shoqëruar/ndaluar në mjediset e këtij komisariati.

### **Ambientet e sigurisë, kushtet e tyre dhe trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve**

Në Komisarlatin e Policisë Sarandë kishte 2 dhoma sigurie me kapacitet për 3 (tre) persona, të cilat ndodheshin në ambientet e godinës së këtij organi dhe shërbenin për sigurimin e personave të rritur. Gjendja dhomave, lidhur me kushtet fizike të tyre, në ambientin e sigurisë nuk ka ndryshuar aspak nga inspektimi i fundit i kryer nga Avokati i Popullit **madje evidentojmë faktin se ato janë degraduar përtej kushteve njerëzore dhe humane për trajtimin e këtyre personave.** Ato janë larg normave, kushteve dhe standardeve për mbajtjen, trajtimin, sigurimin e personave që qëndrojnë në këto ambiente, referuar procedurës standarde: *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1102, datë 07.11. 2017.

Nisur nga gjendja teknike, dhomat ishin të amortizuara dhe ishte evidente lagështira në mure. Dritaret e tyre ishin me përmasa të vogla dhe nuk lejonin futjen e ajrimit dhe të ndriçimit natyral të mjaftueshëm. Në korridorin e ambientit të sigurisë ndodhej një tualet i përbashkët, i cili kishte ujë të rrjedhshëm, por nuk kishte dush me ujë të ngrohtë. Në këtë ambient kishte ndriçim artificial që sigurohej nga rrjeti elektrik. Gjithashtu në ambientin e sigurisë nuk kishte ambient më vete për ajrimin e të arrestuarve/ndaluarve. Në ambientin e sigurisë nuk ishte i instaluar sistemi i monitorimit me kamera.

Në rast mbipopullimi, personat e ndaluar/të arrestuar nga punonjësit e policisë të Komisarlatit të Policisë Sarandë, shoqëroheshin për në dhomat e sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë ose në ambientet e sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastrë.

Në tërësinë e tij ambienti i sigurisë **nuk** plotësonte kriteret dhe kushtet minimale për trajtimin dinjitoz të shtetasve të arrestuar dhe të ndaluar, këto dhoma ishin përtej kushteve normale të realizimit të qëllimi të tyre.

### **Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre**

Në zbatim të kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe procedurave standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*<sup>2</sup> dhe *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*<sup>3</sup>, parashikohet se çdo njësi policore që ka dhoma shoqërimi dhe sigurie, duhet të jetë e pajisur ndër të tjera edhe me regjistrat përkatës.

Gjatë kontrollit të dokumentacionit, u evidentua se, Komisarlati i Policisë Sarandë, ishte i plotësuar me regjistrat e përcaktuar sipas inventarit të procedurave standarde.

<sup>2</sup> Kreu VII, pika 5, parashikuar në Urdhrin Nr. 938, dt. 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shteti *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*.

<sup>3</sup> Kreu XI, pika 1, parashikuar në Urdhrin Nr. 938, dt. 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shteti *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*.

Ato mbaheshin në dhomën e përgjegjësit të dhomave të sigurisë dhe në zyrën e informacionit. Administrimi dhe plotësimi i tyre kryhej nga punonjësit e policisë të ngarkuar me këtë detyrë.

Nga verifikimi, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr.1” sipas procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, i cili mbahej në zyrën e informacionit dhe ishte i sekretuar e i plotësuar sipas rubrikave.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi e shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Kishte disa raste që në rubrikën “*Të dhëna për njoftimin e familjarëve/afërmve*” të të shoqëruarit shkruhej vetëm se familja ishte prezent por nuk pasqyroheshin emri i të njoftuarit dhe numri telefonit, pa shënuar gjeneralitet e plota të personit të njoftuar, lidhja me personin e shoqëruar, si dhe koha e njoftimit.<sup>4</sup> Koha e arrestimit apo ndalimit të të shoqëruarve ishte e njëjtë me kohën e shoqërimit të tyre pranë organit të policisë.

Gjithashtu, në këtë komisariat ishte vendosur regjistri për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e policisë së këtij komisariati.

Nga verifikimi i regjistrave ku evidentohen rastet e shoqërimit dhe të arrestimeve/ndalimeve të kryera nga punonjësit e komisariatit të policisë, konstatoam se, zbatohet rekomandimi i Avokatit të Popullit për ndryshimin e praktikës të viteve të kaluar lidhur me orën e arrestimit dhe ndalimit të shtetasve, duke shënuar në procesverbalet e arrestimit apo ndalimit orën faktike kur ata janë shoqëruar për në organin e policisë, pra në orën kur personit është privuar liria dhe jo orën kur përpilohet procesverbali përkatës.

Nga inspektimi rezultoi se, mungonte regjistri i posaçëm për evidentimin e të dhënave të të miturve në konflikt me ligjin, sipas rekomandimit të Institucionit të Avokatit të Popullit<sup>5</sup>.

Ndërkohë, në zbatim të kërkesave të nenit 115 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, komisariati kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar. Për periudhën Janar - Korrik 2021 nuk ishin evidentuar kërkesa/ankesa nga ana e personave të arrestuar/ndaluar.

### **Ambientet e intervistimit**

Në Komisarlatin e Policisë Sarandë nga informacioni i dhënë nga drejtuesit e policisë, si dhe nga verifikimet në vend i ambienteve të shoqërimit dhe ato të sigurisë, rezultoi

---

<sup>4</sup> *Kreu VII, pika a.1.4 e Procedurave standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.*

<sup>5</sup> *Rekomandim nr.437 prot., datë 11.10.2019 drejtuar Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.*

se pranë tyre nuk kishte asnjë zyrë intervistimi për marrjen në pyetje të shtetasve nga punonjësit e policisë. Shtetasit e ndaluar/arrestuar, para se të futeshin në ambientet e sigurisë, intervistoheshin nga oficerët e policisë gjyqësore në zyrat e punës së këtyre të fundit, të cilat nuk ishin të monitoruara me kamera.

Në lidhje me intervistimin/marrjen në pyetje të persona të mitur, sikurse e përmendëm edhe më lart, ishte krijuar një ambient më vete, brenda godinës të komisariatit. Ky ambient përbëhej nga 2 dhoma të ndara më vete, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrimin ulur të të miturve, kujdestarit ligjor dhe avokatit mbrojtës, si dhe me orenditë për punën që kryejnë specialistët e policisë. Staf i policisë që punonte në “Njësinë për intervistimin e të miturve”, përbëhej nga 2 specialistë policie dhe ishin të trajnuar për këtë qëllim.

Nga monitorimi që u bë në disa prej zyrave të punonjësve të policisë në godinën aktuale të Komisarariatit të Policisë Sarandë, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

### **Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor**

Sipas informacionit dhe nga intervistimi i punonjësit të policisë në zyrën e informacionit, rezultoi se zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde, për plotësimin dhe dhënien çdo personi të shoqëruar, të kopjes së procesverbalit mbi veprimet e kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Nga inspektimi u evidentua se, fashikulli që ndodhej në zyrën e informacionit, përbëhej nga procesverbal tip i emërtuar “Formulari i raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit”, si dhe procesverbali i shoqërimit, të plotësuar sipas rubrikave, të cilët ishin të firmosur nga punonjësi i policisë që kishte trajtuar çështjen dhe personi i shoqëruar. Gjithashtu, personat e shoqëruar në mjediset e policisë pajiseshin me letrën e të drejtave, që në momentin e hyrjes në ambientet e komisariatit.

Për personat e ndaluar/arrestuar, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenet 34/b pika 2 dhe 251 të K.Pr.P, ku thuhet se të ndaluarit/arrestuarit duhet t’i jepet dhe të mbajë me vete një kopje të letrës me të drejtat që gëzojnë këta persona dhe kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit.

Lidhur me të drejtën e ligjshme për informim të personave që ndodhen në dhomat e shoqërimit, si dhe në ambientet e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Sarandë, gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e tyre ishin të afishuara posterat me të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar, si dhe atyre të shoqëruar, por u vërejt se ato ishin të vjetruara dhe kishte nevojë për rifreskimin tyre. Ndërsa për shtetasit e ndaluar/arrestuar të huaj, u konstatua se punonjësit e zyrës të informacionit dispononin formularë me të drejtat e të ndalurve/arrestuarve në disa gjuhë të huaja dhe ato ishin pjesë e dokumentacionit që shoqëronin këta persona.

Në takimin që grupi i inspektimit zhvilloi me punonjësit e shërbimit në dhomat e sigurisë, rezultoi se, zbatohet detyrimi ligjor për të informuar personat e ndaluar/arrestuar në moshë madhore se, në mungesë të mundësive financiare për të pajtuar një avokat mbrojtës, mund të kërkojë ndihmë juridike dhe ti ofrohet një Avokat

mbrojtës kryesisht nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, e cila ishte e afishuar në zyrën e përgjegjës të dhomave të sigurisë.

Gjithashtu, në lidhje me trajtimin e personave në momentin që hyjnë në komisariatet e policisë, sjellim në vëmendje nevojën e verifikimit të gjendjes fizike të personave, për të mënjanuar përgjegjësinë e autoriteteve të policisë, për çështjet e dhunës, sipas rekomandimit edhe të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Dënimit Çnjerëzor ose Poshtëruës (CPT), i cili në raportin për Shqipërinë të botuar në vitin 2019, midis të tjerave ka cituar se: *“Oficerët e policisë duhet të trajtohen që të mos përdorin forcë më shumë sesa është e nevojshme dhe se ajo mund të përdoret vetëm në rast të kapjes së një personi. Pasi ai është arrestuar dhe mbahet nën kontroll, nuk mund të ketë asnjë justifikim për goditjen e tij. Kur vlerësohet e nevojshme të prangoset një person, prangat në asnjë rrethanë nuk duhet të jenë tepër të shtrënguara dhe duhet të mbahen për aq kohë sa është e nevojshme”*<sup>6</sup>.

Në lidhje me shtetasit e ndaluar/arrestuar të huaj, për të garantuar të drejtat e tyre, ishte përkthyer letra me të drejtat në disa gjuhë të huaja, si anglisht, spanjisht, frëngjisht, italisht, greqisht, gjermanisht, maqedonisht, serbisht, sllovenisht dhe gjuhën rome.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht, kujdestarit ligjor dhe të psikologut i cili thirrej nga gjykata pasi që nuk ishte në organikën e Komisarariatit të Policisë Sarandë.

Grupi i inspektimit konstatoi gjithashtu se, vizitat mjekësore e të ndaluarve/arrestuarve nga ana e personelit mjekësor ishin kryer brenda afatit 12 orësh nga koha e vendosjes së tyre në këtë ambient, sikurse përcaktohet në procedurat standarde: *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*.<sup>7</sup> Vizitat mjekësore e të ndaluarve/të arrestuarve kryhej nga një mjek i Spitalit të Sarandës, pasi Komisaritati Policisë Sarandë nuk ka në organikë personel mjekësor. Shënimet me konstatimet, rekomandimet dhe mjekimet e dhëna pasqyroheshin në regjistrin e vizitave mjekësore. Ndërkohë nga personeli mjekësor hapeshin edhe kartelat mjekësore (kartelat ditore) të tyre, të cilat vendoseshin në fashikullin përkatës për çdo të ndaluar/arrestuar.

Në përfundim të inspektimit, grupi inspektues administroi në dosjen e inspektimit kopje të shkresave zyrtare për nevojën e buxhetimit në kryerjen e investimeve në dhomat e shoqërimit dhe ambientet e sigurisë, me qëllim përmirësimin e kushteve materiale dhe infrastrukture të tyre sipas standardeve ligjore. Nga intervistimi me drejtuesin e komisariatit, u konstatua se fondet për këto investime që ishin përfshirë fillimisht në projektet që do të realizoheshin për vitin buxhetor 2019 tashmë janë shtyrë për vitin 2022 sipas shkresës së Ministrisë së Brendshme me nr. 9136/14 prot., datë 10.02.2021 me lëndë *“Dërgohet detajimi i buxhetit të vitit 2021-2023, për shpenzimet kapitale”* ku ishte parashikuar ndërtimi/rikonstruksioni i godinës së Komisarariatit të Policisë Sarandë.

<sup>6</sup> CPT ka bërë publik në datën 17.09.2019, raportin mbi vizitat që ka kryer në disa institucione të privimit të lirisë në Shqipëri, nga data 20 deri në datën 30 Nëntor 2018. <https://www.coe.int/en/web/cpt/-/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-alban-3>

<sup>7</sup> Kreu II, pika 7, procedurave standarde: *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*



Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ku parashikohet midis të tjerash se: “Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca:

b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues.”.

### **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave të menjëhershme për mbylljen dhomave ekzistuese të sigurisë në Komisaratin e Policisë Sarandë, pasi ato nuk janë të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë dhe nuk plotësojnë asnjë nga kriteret e parashikuara në procedurat standarde të më sipër cituara.
2. Marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin e ambienteve të reja të sigurisë sipas procedurave standarde: “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1102, datë 07.11. 2017 në Komisaritet e Policisë Sarandë dhe Vlorë, të cilat të jenë të **pajisura me sistemin e kamerave.**
3. Marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin në Komisaritet e Policisë Sarandë të ambienteve të shoqërimit sipas kriterëve të parashikuara në procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, **duke krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur, të pajisur me sistemin e kamerave.**
4. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin dhomës (zyrës) më vete në ambientin e sigurisë, për marrjen në pyetje të personave të ndaluar/arrestuar, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera.
5. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin të dhomës (zyrës) në ambientin e shoqërimit, për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera.
6. Marrjen e masave të menjëhershme për rishikimin e strukturës/organikës së këtij institucioni dhe veçanërisht me shtimin e mjekut, psikologut dhe juristit.
7. Marrjen e masave të menjëhershme, për vendosjen në zyrën e informacionit të regjistrat për evidentimin e të dhënave të të miturve që shoqërohen në mjediset e Komisaritetit të Policisë Sarandë.
8. Marrjen e masave të nevojshme me qëllim plotësimin me saktësi dhe përgjegjësi të “Regjistrave të evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” nga punonjësit e policisë në Komisaritet e Policisë Sarandë.

9. Marrjen e masave për vendosjen e materialeve promovuese (postera) për njohjen e personave të shoqëruar dhe personave të arrestuar/ të ndaluar në Komisarjatin e Policisë me të drejtat e tyre në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj.

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONER**

**ERMONELA XHAFA**

Konc&Dakord.:  
G. Çarkaxhiu  
B. Deda  
H. Selita